

KONTRATE SHITJEJE

Ne Tirane sot me date 06.08.2003, lidhet kjo kontrate shitje midis paleve si me poshte:

Shites: Z. Shpetim Prodani i biri i Indrita, i datelindjes 2.11.1970, me banim ne Durres, Lagja, 2. Rr. Agim Apollon, me numer leternjoftimi 0534505.

Bleres: Z. Harito QIRKO i biri i Spiros, i datelindjes 02.09.1950, me banim ne Tirane, Lagja, Nr 8 Rr. Dora D'Iskria, me numer leternjoftimi Az Nr 1066.18.

Baza Ligjore: Nent 705 vijuese, te kreut te I-re, titulli II-te te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Neni 1

Objekti i kontrates

Kalim i pronesise te nje numri prej 3 300 (tremije e treqind) te aksioneve te Shoqerise se Sigurimeve SIGMA sh.a nga shitesi tek bleresi kundrejt cmimit përej 14,721,983.87Leke.

Neni 2

Cmimi i shitjes

Aksionet shiten me cmimin e tyre faktik, prej 15,000,000.00 Leke

Neni 3

Detyrimet e paleve kontraktuese

Menjehere pas perpilimit te kesaj kontrate shitesi merr persiper t'i dorezoje bleresit aksionet ndersa ky i fundit detyrohet te shlyej ne total vleren e tyre sipas nenit 2 me siper.

Neni 4

Pasojat e kontrates

Pas nenshkrimimit te kesaj kontrate shitesi humbet cdo te drejte pronesie mbi objektin e shitjes, ndersa bleresi behet pronar i vetem i aksioneve. Bashke me aksionet, shitesi i dorezon bleresit te gjith dokumentacionin qe verteton pronesine mbi to.

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Neni 5

Pergjegjesite e paleve

Shitesi ka pergjegjesi per fshehje te te metave apo rrethanave te tjera qe lidhen me objektin e shitjes.

Bleresi mund t'i denoncoje shitesit te metat lidhur me objektin e shitjes jo me vone se nje muaj nga data e zbulimit te tyre.

Neni 6

Mosmarreveshjet

Mosmarreveshjet do te zgjidhen me mirekuptim midis paleve, ne te kundert kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Tirane


Neni 7

Dispozita te fundit

Kjo kontrate u hartua sipas vullnetit te lire e te plote te paleve kontraktuese, te cilat pasi e lexuan e nenshkruajne ate rregullisht

SHITESI

SHPETIM PRODANI



BLERESI

HARITO QIRKO

